



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:187062

Datë: 24.01.2022

Numri i dokumentit: 02634388

C. nr. 1016/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditësit XH.ZH nga fshati Moglicë, Komuna e Gjakovë, përfaqësuar nga Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale Arsimit përfaqësuar nga D. N. H., për kompensim të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, vlera kontestit 1,735.62 euro, jashtë seancës me datë 24 janar 2022, murr këtë;

A K T V E N D I M

Konsiderohet e TËRHEQUR padija në këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave me rastin e pensionimit në shumë 867.81 euro si dhe shpërblimin jubilar në shumë 867.81 euro, në shumë të përgjithshme 1, 735.62 euro së bashku me kamatën ligjore.

Me parashtrësën e datës 05 janar 2022 i autorizuari i paditësit ka bërë tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko civile, pasi çështjen do të tentojnë të e zgjidhin me marrëveshje jashtë gjyqësore.

E paditura është njoftuar me parashtrësën e palës paditëse me datë 13 janar 2022. Brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk është deklaruar për këtë gjë, konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë, sipas nenin 261.2 të LPK-së dhe padia u konsiderua e tërhequr.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C. nr. 1016/20, Datë 24 janar 2022

Gjyqtarja
Afijete Sada – Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër Aktvendimit nuk është i lejuar Ankimi, sipas nenit 261.4 të LPK-së.